



Organization for Security and Co-operation in Europe

**Spillover Monitor
Mission to Skopje**

Sektori për Reformë të Administratës Publike

SKEMA PËR GRANT PËR BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL 2008

UDHËZIME PËR KONKURRUESIT

Përmbajtja:

1. Historiku
2. Objektivi i Programit për BNK të OSBE-së
3. Rregullat për këtë shpallje për propozime
 - 3.1. Kriteri i të drejtës për konkurrim
 - 3.1.2. Pranueshmëria e propozimeve
 - 3.1.3. Pranueshmëria e kostove
4. Si të konkurrohet dhe procedurat që duhet respektuar
5. Vlerësimi dhe seleksionimi i konkurruesve
 - 5.1 Kriteret e vlerësimit

1. Historiku

Bashkëpunimi Ndër-Komunal (BNK) është një mjet efektiv për dhënie të shumë shërbimeve qytetarëve, në veçanti nga ana e komunave të vogla. Iniciativat e partneritetit në mes dy ose më shumë njësive të vetëqeverisjes lokale vetëm se janë një praktikë që ekziston në vend, dhe shumë administrata e konsiderojnë BNK si një strategji për tejkalimin e vështirësive në menaxhimin e të gjitha kompetencave që dalin nga Ligji i Vetëqeverisjes Lokale të vitit 2002. Analiza e Decentralizimit të bërë nga OSBE Misioni Vëzhgues në Shkup zbuloi se marrëveshjet e BNK kryesisht janë në përdorim për fushat siç janë planifikimi urban, administrimi taksave e pagesave dhe zhvillimi ekonomik lokal, kjo e fundit e identifikuar nga ana e shumicës së Kryetarëve të Komunës si fusha më e rëndësishme e aktivitetit për partneritetet e ardhshme të BNK.

Koncepti i bashkëpunimit ndër-komunal (BNK) është në princip i rregulluar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale por Ligji as nuk e definojnë strukturën ligjore të modeleve të BNK as nuk tregon fushat e shërbimeve ku duhet të aplikohet BNK. Ligji vetëm se autorizon bashkëpunimin në mes të komunave duke lënë që natyra dhe instrumentet e nevojshme për këtë të jenë në bazë vullnetare dhe jo të detyrueshme. Për momentin po punohet në një ligj për bashkëpunim ndër-komunal por nuk është aprovuar nga Qeveria dhe Parlamenti si rezultat i procesit konsultativ që është në vijim mes BNjVL dhe Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale, ligjvënësi pranon vlerën e praktikave të BNK; p.sh. disa administrata lokale kanë përfituar nga rasti i përbashkët i stafit të parashikuar me Ligjin për Financim të vitit 2004 (2 të punësuar më menaxhim financiar dhe 3 të punësuar për administratën për taksa dhe pagesa), deri më tani i treguar me rezultat të shkëlqyer.

Përvojat tregojnë se BNK, edhe pse paguhet dhe ia vlen në afate më të gjata, shumë shpesh është tepër e shtrenjtë për komunat e vogla – të cilat në të njëjtën kohë janë përfituesit kryesorë të partneriteteve ndër-komunale. Kjo pengesë parandalon përhapjen e mëtejme të praktikës së BNK dhe skema për grant për BNK 2008 e OSBE-së do të kontribuojë në tejkalimin e këtij problemi specifik.

2. Objektivi i skemës së OSBE-së për grant për BNK 2008

Objektivi thelbësor i skemës së OSBE-së për grant për BNK 2008 është për të përkrahur implementimin e partneriteteve ndër-komunale me anë të dhënies së stimulimeve financiare. Skema për grant do të konceptohet si kontribut për realizimin e iniciativave për përfitim të ndërsjellë për të gjithë partnerët e propozuar dhe në asnjë rast nuk duhet të përdoret për të financuar harxhimet që janë në suaza dhe në kompetencë të komunave individuale.

3. Rregullat e skemës së OSBE-së për grant për BNK 2008

Shuma e përgjithshme e kësaj skeme për grant është 60,000 Euro. Lartësia maksimale e një aplikimi për grant është 20,000 Euro. Këto udhëzime – të cilat janë në pajtim me rregullat e OSBE-së për implementim dhe prokurim – i përcaktojnë rregullat e dorëzimit, seleksionimit dhe të implementimit të propozimeve për BNK. Për çështjet të cilat nuk janë të rregulluara me anë të këtyre udhëzimeve atëherë do të aplikohen normat dhe rregullat e OSBE-së.

3.1. Kriteri i të drejtës për konkurrim

Ekzistojnë tre pako të kriterëve e të drejtës për konkurrim.

- Konkurruesit të cilët mund të kërkojnë grant
- Propozimet për të cilat mund të akordohet granti – marrëveshje të pranueshme për BNK
- Lloje të kostove të cilat janë të pranueshme për grant

3.1.1. Përshatshmëria e konkurruesve

Këto kritere duhet të plotësohen në kuptim kumulativ

- Konkurruesit duhet të jenë komuna

Skema për grant është vetëm për komunat; aplikacionet duhet të vijnë ekskluzivisht nga ana e konsorciumit të dy ose më shumë komunave. Për këtë arsye, aplikacionet e pranuar nga kompani publike dhe OJQ nuk do të pranohen. Megjithatë, aktivitetet mund të kontraktohen për mbështetje tek palë të treta nëse këto palë pranojnë komunat propozues si pronarë të vetëm të projektit. Palët e treta duhet të jenë të regjistruar së paku 12 muaj para botimit të udhëzimeve momentale.

- lejohej të ketë vetëm një aplikacion prej një komune

Në rast se ka më shumë se një aplikacion të dorëzuar nga komuna (t), komuna(t) do të diskualifikohen.

- Aplikacionet duhet të jenë për BNK të më së paku dy komunave.

Aplikacionet duhet të përfshijnë së paku dy komuna. Preferencë do të jepet aplikacioneve të cilat përfshijnë së paku një komunë e cila nuk ka hyrë në fazën e dytë të decentralizimit fiskal deri në momentin e botimit të udhëzimeve momentale.

Aplikacioni duhet të tregojë se cila komunë do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e Programit. Secili aplikacion për projekt duhet të definojë një konkurrues si partner udhëheqës të përgjithshëm i cili do të nënshkruajë – në emër të Kryetarit të Komunës – dhe të dorëzojë propozimin në emër të tjetrit (tjerëve). Aplikacionet duhet të përmbajnë letra të miratimit nga të gjithë këshillat komunal të përfshirë, dhe një dokument të nënshkruar dhe të vulosur nga autoritetet relevante të komunës duke paraparë që të gjitha aktivitetet e ndërmarra në lidhje me projektin do të jenë plotësisht në pajtim me ligjet vendore. Komuna udhëheqëse do të nënshkruajë kontratën me OSBE-në.

- propozimet që veç më janë të financuara nuk do të pranohen.

Konkurruesi nuk duhet të dorëzojë propozim i cili është zbatuar më parë me fonde të siguruar nga donatorë tjerë. Fondet nga ky grant mund të përdoren për aktivitete plotësuese të projekteve të financuara nga donator tjetër vetëm me një konsensus oficial të donatorit, i cili duhet të bashkëngjitet aplikacionit. Në rast se propozim projekti – plotësisht ose pjesërisht – tashmë është dorëzuar deri te donatorë tjerë si pjesë e aktiviteteve tjera për mbledhje të fondeve nga ana e konkurruesit, duhet të shkruhet një letër relevante lidhur me të.

3.1.2. Pranueshmëria e propozimeve

Marrëveshjet BNK përmbajnë një pako të aktiviteteve të cilat duhet qartë të përshkruhen në Formularin e Aplikacionit për Grant, përfshirë këtu edhe dokumentacionin kur ai kërkohet.

Skema e grantit e pasqyruar këtu mëton të adresojë dhe të përgjigjet nevojave të natyrës administrative siç janë mbledhja e tatimeve, administrimi i tatimeve, planifikimi urbanistik, dhënia e lejeve dhe licencave, inspektimit të përbashkët, dhe detyra të ngjashme. Projektet të cilat kërkojnë intervenime infrastrukture nuk do të pranohen në bazë të skemës për grant këtu të përshkruar.

Të gjitha aktivitetet të përfshira në mesin e kompetencave të numëruara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të vitit 2002 dhe të Ligjit për Financim të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të vitit 2004 kanë të drejtë konkurrimi si propozime.

Të gjitha projektet e zgjedhura do të duhet të shndërrohen në marrëveshje ligjore mes OSBE-së dhe konsorciumit të propozuar; marrëveshjet do të përmbajnë datën e fillimit të aktiviteteve. Të gjitha aktivitetet dhe kostot e tyre duhet të përmbushen deti më 31 dhjetor 2008.

Në asnjë rrethanë llojet e marrëveshjeve në vijim nuk do të konsiderohen të pranueshme:

- Themelimi i ndërmarrjes së përbashkët komunale (publike) dhe kërkesa për paanësi
- Themelimi i kompanive private
- Konferenca dhe/ose punëtori të njëhershme: konferencat dhe ose punëtoritë mund të financohen vetëm në rast se ato janë pjesë e aktiviteteve me diapazon më të gjerë të zbatuara gjatë kohëzgjatjes së Programit. Botimi i materialeve në lidhje me punëtoritë dhe konferencat jashtë fushës së diapazonit përfshirës të aktiviteteve nuk do të pranohet.

3.1.3 Pranueshmëria e Kostove

Vetëm kosto të pranueshme do të merren parasysh për grant. Buxheti i Aplikacionit është një vlerësim i koston dhe lartësia maksimale e kostove të pranueshme.

Gjatë procesit të vlerësimit të buxhetit të propozuar të Aplikacionit mund të përfshihen edhe gabime aritmetikore, kosto joreale dhe kosto jo të pranueshme. Komisioni për vlerësim mban të drejtën për të kërkuar sqarim i cili mund të çojë deri te kërkesa për modifikime ose reduktime me qëllim që të korrigjohen gabimet.

Resurset njerëzore

Kostot për stafin për menaxhim të projektit (lideri i ekipit + nëpunësi financiar) nuk duhet të tejkalojë 20 % të buxhetit të përgjithshëm. Nëpunësit shtetërorë (përfshirë edhe stafin e komunës) nuk guxojnë të pranojnë kurrfarë pagese për punë të menaxhimit në lidhje me projektin, por përkrahja e tyre në menaxhimin e projektit mund të shënohet dhe të konsiderohet si kontribut jo i paguar nga konsorciumi i konkurruesve.

Lejohet angazhimi i ekspertizave në lidhje me sferën e propozimit. Ekspertët e punësuar për zbatimin e projektit duhet të përzgjidhen me konkurs të hapur.

Komuna e cila vepron si udhëheqëse e projektit është përgjegjëse për vëzhgimin nëpunësve të administratës publike, të cilët mund të angazhohen vetëm si ekspertë/konsulentë, nëse ata japin shërbime jashtë orarit të tyre të punës, dhe nëse po, ata duhet të jenë në pushim vjetor të aprovuar ose në pushim të posaçëm pa pagesë.

Të mirat dhe shërbimet

Blerja e të mirave dhe shërbimeve vlera e përgjithshme e të cilave është mbi 500 Euro duhet të bëhet me anë të një procedure ofertuese në të cilën së paku tri oferta çmimesh realisht përgjegjëse janë pranuar. Propozimet duhet qartë të tregojnë përfituesit final nga gjerat e blera me fondet e OSBE-së. Kostot për prokurimin e të mirave nuk mund të jenë më të larta se 30% të buxhetit të projektit.

Kontributi nga komunat

Propozimet duhet të përmbajnë evidencën e kontributeve nga konkurruesit në vlerë të përgjithshme prej së paku 20% të buxhetit të propozuar. Hollësi për llojin e kontributit duhet

dhënë në pajtim me kriteret e pasqyruara në formularin për aplikim dhe do t'i nënshtrohen vlerësimit nga ana e panelit seleksionues.

Kontributi jo i paguar nga fondi i projektit është harxhim aktual i bartur nga konkurruesi(t) dhe duhet të shënohet në buxhet të veçantë. Këto kontribute mund të jenë rrogat e stafit të caktuar për projektin, marrja me qira e objekteve, përdorimi i pajisjeve dhe të ngjashme.

Në asnjë rrethanë llojet e kostove në vijim nuk do të konsiderohen si të pranueshme:

- Pagimi i detyrimeve (borxheve)
- Artikuj të buxhetit të financuar nga donator tjetër dhe/ose buxhet komunal
- Blerje të tokës, godinave
- Të drejtë për themelimin e ndërmarrjeve publike dhe/ose për blerje të aksioneve
- Kredi për palë të treta

4. Si të konkurrohet dhe procedurat që duhet respektuar

Komunat e interesuara duhet të dorëzojnë propozimet e tyre duke përdorur formularin për aplikim që gjendet në <http://www.osce.org/tenders/30921.html>. Aplikacionet duhet të dorëzohen në gjuhën maqedonase. Nëse ekziston dëshira ato gjithashtu mund të dorëzohen në mënyrë plotësuese (përveç në versionin maqedonisht) edhe në cilëndo gjuhë tjetër zyrtare të pranuar brenda kufijve të Komunës në fjalë. Një përmbledhje e shkurtë e propozimit në gjuhën angleze duhet të dorëzohet duke përdorë shabllonin e dhënë në Aneksat. Aplikacionet duhet të jenë të lidhura (të mos ketë fletë të ndara) dhe aplikacionet e plotësuar në dorë nuk do të pranohen. Të gjithë dokumentet që kërkohen në bazë të udhëzimeve aktuale duhet t'i bashkëngjiten propozimit.

Aplikacionet duhet të pranohen në një zarf të vulosur dhe të regjistruar nga posta, korrieri ose me anë të dërgimit në dorë (vërtetim për pranim i nënshkruar dhe me datë do të jepet me pranim të zarfit) në adresën më poshtë:

Adresa Postare /Adresa për dërgesë me dorë /Dërgesë me shërbim privat korrieri:

Spektori për Reformë të Administratës Publike
OSBE Misioni Vëzhgues në Shkup
Ndërtesa QBE Makedonija (kati 6të) Rr. 11 Oktomvri, Nr. 25, MK-1000 Shkup

Aplikacionet e dërguara me çfarëdo mjeti tjetër (p.sh. me faks ose me e-mail) ose të dërguara në adresë tjetër do të refuzohen.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në një ekzemplar origjinal dhe katër kopje tjera.

Afati i fundit për pranimin e aplikacioneve është **15 qershor 2008 ora 17:30**; çdo aplikacion i pranuar pas afatit të fundit automatikisht do të refuzohet përsëri faktit nëse vula postare tregon datë më të hershme se afati i fundit apo nëse shkak i vonës është lëshimi i shërbimit korrier privat.

Pyetjet në lidhje me sqarimin e këtyre udhëzimeve mund të dërgohen me anë të postës elektronike ose faksit jo më vonë se deri më 31 maj 2008 në adresën e shënuar më poshtë, duke shënuar qartë referencën për shpalljen për propozime:

Departamenti për Reformë të Administratës Publike
OSBE Misioni Vëzhgues në Shkup

Ndërtesa QBE Makedonija (kati 6të) Rr.11 Oktomvri, Nr. 25, MK-1000 Shkup
Faksi:[+389 2] 3234234
E-mail: grantsIMC2008@osce.org

Përgjigje pyetjeve për qartësim dhe kërkesave për informacion të mëtejme do të jepen jo më vonë se 7 ditë para afatit të fundit për pranimin e propozimeve. Të gjitha përgjigjet do të shkarkohen në faqen e internetit <http://www.osce.org/tenders/30921.html>. Konkurruesit nuk duhet të dërgojnë drafte të propozimeve të tyre për rishikim.

5. Vlerësimi dhe Seleksionimi i Konkurruesve (Paneli seleksionues + fazat)

Aplikacionet që plotësojnë të gjitha kriteret të pasqyruara në kaptinat e lartshënuara të këtyre udhëzimeve do të vlerësohen nga ana e panelit seleksionues të përbërë nga:

- 3 përfaqësues të Sektorit për Reformë të Administratës Publike pranë OSBE Misionit Vëzhgues në Shkup
- 1 përfaqësues të UNDP
- 1 përfaqësues nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale

Rezultatet e seleksionimit do të publikohen në faqen e internetit të OSBE-së 15 ditë pas afatit të fundit për dorëzimin e aplikacioneve. Konkurruesit e propozimeve të përzgjedhura do të informohen me postë. Konkurruesit do të marrin rezultatet e vlerësimit të propozimeve të tyre nëse kërkojnë një gjë të tillë.

Procesi i seleksionimit dhe vlerësimit do të realizohet në pajtim me kriteret të fiksuara.

Konkurruesit e propozimeve të seleksionuara do të kontaktohen nga ana e përfaqësuesit të Sektorit për Reformë të Administratës Publike pranë OSBE Misionit Vëzhgues në Shkup; OSBE do të bën marrëveshje me 3 konsorciumet më të mira të përzgjedhura propozimet e të cilëve, sipas vendimit të panelit, do të përzgjidhen për implementim me grante të këtij projekti. OSBE mban të drejtën për të modifikuar projekt propozimet e përzgjedhura para hyrjes në marrëveshje kontraktuese me komunat udhëheqëse të konsorciumeve.

5.1. Kriteret për vlerësim

Paneli për vlerësim do të rishikon të gjitha propozimet me të drejtë konkurrimi në pajtim me kriteret të theksuar më poshtë:

Vlerësimi i Aplikacioneve do të bëhet në dy faza, d.m.th. pëlqimi administrativ dhe teknik.

Pëlqimi administrativ:

Pëlqimi administrativ përfshinë kriteret në vijim:

- 1) Komuna ka dorëzuar NJË propozim si Komunë Udhëheqëse ose Partnere
- 2) Formulari i Aplikacionit është i mbyllur dhe i vulosur në çdo faqe nga ana e Kryetarëve e të GJITHA komunave
- 3) Vërtetim se Formulari i Aplikacionit është i shoqëruar me një miratim nga të GJITHË këshillat komunal sa i përket marrëveshjes për BNK dhe se një dokument i

nënshkruar dhe i mbyllur nga ana e autoriteteve relevante të komunave duke treguar se të gjitha aktivitetet e ndërmarra në lidhje me këtë projekt do të jenë në pajtim të plotë me ligjet vendore.

- 4) Vërtetim se të gjitha pjesët e Formularit për Aplikim janë plotësuar
- 5) Vërtetim se shuma e kërkuar e grantit nuk e tejkalon shumën maksimale të buxhetit prej 20.000 Euro, duke mos përfshirë kontributet që nuk paguhen nga buxheti i projektit

Aplikacioni i cili nuk i përmbushë plotësisht kriteret për pëlqim administrativ do të refuzohen.

Pëlqimi teknik:

Vlerësimi i pëlqimit teknik do të bëhet në pajtim me kriteret fikse të theksuara në Tabelën e Vlerësimit:

- 1) Aplikacioni kontribuon për krijimin e sistemit dhe/ose të kushteve për dhënie të shërbimeve të përbashkëta ose të sistemit për administrim ose krijim të partneritetit të përbashkët për planifikim dhe koordinim të aktiviteteve të përbashkëta
- 2) Aplikacioni propozon strukturë menaxhimi për vendimmarrje për BNK të përbërë nga përfaqësues të gjitha komunave pjesëmarrëse
- 3) Modaliteti i zbatimit të projektit (cilësia e menaxhimit të propozuar të projektit)
- 4) Aplikacioni qartë shpjegon ndikimin e BNK të propozuar për përmirësimin e ekzekutimit të një detyre administrative ose dhënies së një shërbimi ose të një ekzekutimi të përbashkët të një aktiviteti
- 5) Aplikacioni demonstroi qëndrueshmëri të një BNK edhe pas përfundimit të projektit
- 6) Në rast se BNK e propozuar përfaqëson vazhdim ose mbindërtim/shtim të BNK të përfunduar, Aplikacioni qartë tregon përfitimet nga përfundimi i BNK
- 7) Shuma e propozuar e kontributeve jo të paguara nga fondi i projektit (së paku 20% të shumës së përgjithshme të grantit) dhe kontribut eventual në para të gatshme (minimum 4%)
- 8) BNK përfshinë komunën e cila nuk ka hyrë në fazën e dytë prej datës së dorëzimit të Formularit për Aplikim

Tabela e Vlerësimit

<i>Kriteret</i>	<i>nota</i>
Një ose më shumë konkurrues ende nuk janë në fazën e 2të të decentralizimit fiskal deri në datën e botimit të udhëzimeve të prezantuara	2
1 ose më shumë objektivë janë në lidhje me të arriturat e kriterëve të fazës së 2të	5
Administratë të përbashkët ose dhënie të komponentëve të shërbimeve të prezantuara në propozim	5
Të gjitha komunat konkurruese janë fqinje	5
Komponentët gjinor dhe multi-etnik janë të pranishme në propozim	5
Kontributet në para të gatshme nga konkurruesit (së paku 4% nga buxheti i përgjithshëm)	5
<i>Cilësia e propozimit:</i>	
<i>1) realizueshmëria e aktiviteteve të propozuara (afatet kohore dhe resurset kundrejt objektivave)</i>	<i>1-10</i>
<i>2) Struktura dhe mekanizmi për menaxhim të përbashkët i propozuar për koordinim mes partnerëve</i>	<i>1-10</i>
<i>3) Qëndrueshmëria pas përfundimit të projektit</i>	<i>1-10</i>
<i>4) Shpërndarje e drejtë e përfitimeve/rezultateve në mesin e konkurruesve</i>	<i>1-10</i>

Kriteret në lidhje me cilësinë e propozimit do të merr notë prej 1 deri 10 në bazë të udhëzimeve në vijim:

- 1 = skajshmërisht i dobët
- 2 = shumë i dobët
- 3 = dobët
- 4 = pamjaftueshëm
- 5 = varfër
- 6 = pranueshëm
- 7 = arsyeshëm
- 8 = mirë
- 9 = shumë mirë
- 10 = shkëlqyeshëm